

ditën e tretë nga vrasja, komanda policore e ka urdhëruar një njësit të NJPP–së që me ndihmën e serbëve nga Skënderaj/Srbica ta bënin varrosjen e shqiptarëve të vrarë. Megjithatë, familjarët dhe banorët e fshatit i kanë zhvarrosur trupat e të vrarëve më 11.03.1998 dhe e kanë organizuar varrimin e tyre të përbashkët në varrezat në *Mëhallën Jashari* [Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze]. Në varrim kanë marrë pjesë dhjeta mijëra shqiptarë dhe dy serbë.

Pas lufte, Kuvendi i Kosovës i ka shpallur të gjithë anëtarët e rënë të familjes Jashari dëshmorë të luftës, ndërkaq shtëpia familjare e Shaban Jasharit u shndërrua në monument përkujtimor.

Burimet: deklarata FJ, FDH-36706; deklarata B.J, FDH-32464; deklarata H.G, FDH-31871; deklarata S.J, FDH-20313; deklarata H.J, FDH-31872; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, N, 183, 191; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, II, 315; FHP, *Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću*, III, 229-232; Film dokumentar, *War in Europe*, PBS Frontline, 2000, FDH-35222; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oružanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; J. Martinsen, *Regjstri...*, FDH-26092; SHFĐUÇK, *Feniksët...2*, 231-236; SHFĐUÇK, *Feniksët...5*, 301-303; KMDLNI, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 17-18, 130-131, FDH-23807; Bardhyl Hamzaj i Faik Hoti, *Jasharet*, Zerri, 2003, FDH-36789; FDH, penale (Radoslav Mitrović dhe të tjerë), 2.03.2009, FDH-36787.

Isak (Feriz) Halili

(20.01.1934, shqiptar nga Duboci/Dubovac, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, punëtor ndërtime, nëntë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Isaku me familje jetonin në Duboc/Dubovac. Ai dhe i vëllai Sadiku kanë qenë shumë të afërt me familjen Jashari nga **Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze**. Në mëngjes, më 5.03.1998, vëllezërit Halili e dëgjuan krismën e armëve nga drejtimi i Prekazit të Poshtëm/Donje Prekaze. I rrokën armët dhe shkuan drejt *Mëhallës Jashari*. Isaku ka rënë në afërsi të shtëpisë së Shaban Jasharit [7.03.1998], ndërkaq Sadikun e kanë plagosur rëndë. Isakun e kanë varrosur më 11.03.1998 në varrezat e *Mëhallës Jashari*, së bashku me

bashkëluftëtarët e tij dhe viktimat e tjera.

Burimet: deklarata M.H, FDH-32800; KM-DLNI, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 130-131, FDH-23807; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; J. Martinsen, *Regjstri...*, FDH-26092; FHP, penale (Radoslav Mitrović dhe të tjerë), 2.03.2009, FDH-36787.

Qazim (Osman) Jashari

(20.04.1948, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, mësues, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Beqir (Bajram) Jashari

(30.03.1955, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor në Fabrikën e Municionit, pesë fëmijë)

Halil (Bajram) Jashari

(15.06.1960, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, teknik i makinerisë, një fëmijë)

Nazmi (Zukë) Jashari

(14.11.1967, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, tregtar, një fëmijë)

Në mëngjes, më 5.03.1998, kur forcat speciale policore të Serbisë e nisën sulmin ndaj *Mëhallës Jashari* dhe **Prekazit të Poshtëm/Donje Prekaze**, mësuesi i fshatit Qazimi me familje u strehuan te kushërinjtë Beqir dhe Halil Jashari. Aty u strehuan edhe familjarët e Sherif, Zukë dhe Fejzë Jasharit. Prona e Beqirit dhe Halilit gjendej në vazhdimësi të asaj të Shaban Jasharit, dhe, rrjedhimisht, burrat iu bashkëngjiten mbrojtjes që nga mëngjesi. Halili ka pësuar në çastin kur nga pozicioni i tij u nis drejt shtëpisë së Shaban Jasharit. Nga ora 13:30, predhat e kanë rrënuar kulmin e shtëpisë së Beqirit dhe Halilit, ndërkaq, më pas, edhe katin e dytë të shtëpisë dhe shkallët e saj. Pastaj, policia e ka hedhur gazin lotsjellës në shtëpi dhe përmes megafonit i ka ftuar në gjuhën shqipe të gjithë familjarët që të dilnin në oborr. E para ka dal bashkëshortja e Sherifit me fëmijët e saj, ndërkaq pas saj filluan të dilnin edhe anëtarët e tjerë të familjes. Kur Qazimi u paraqit në derë me duart e ngritura, policët shtënë dhe e vranë në vend. Kjo e shkaktoi panikun në mesin e civilëve. Gratë dhe